

**FORMULARI NUMËR 3**  
**KONCEPTDOKUMENTI PËR KRYEPROKUROR**

Mbiemri:	Petrit
Emri:	Kryeziu

Bazuar në kompetencat ligjore të parapara për pozitën që aplikoni, ju lutem të ofroni:

➤ **I. Analizën tuaj: 1. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në Prokurorinë e Shtetit?**

Gjendja aktuale në Prokurorinë e Shtetit vlerësoj që shfaqet problematike, kjo përfshirë faktin se në vazhdimësi – në baza ditore ballafaqohemi me sulme të ndryshme ndaj sistemit prokurorial duke përfshirë këtu edhe mos përbajtjen e autoriteteve publike nga kritikat e panevojshme ndaj sistemit të drejtësisë duke ndikuar kështu edhe në qytetarin, ky i fundit jep shenja të qarta se duhet bërë më shumë përfshirë fituar besimin e duhur qytetarë në sistemin prokurorial. Jemi dëshmitarë përfshirë sfidat nëpër të cilat ka kaluar institucioni i Prokurorit të Shtetit, duke përfshirë ndërhyrje të ndryshme dhe të vazhdueshme në pavarësinë e sistemit prokurorial duke krijuar pasiguri te prokurorët, nisur nga tendenca përfshirë uljen e pagave dhe mos ndarjen buxhetore koherente sipas kërkjesave të prokurorisë së shtetit duke pamundësuar rritjen e numrit të prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit mbështetës, deri te fakti që institucioni më i rëndësishëm i ndjekjes vazhdon të udhëhiqet nga ushtruesi i detyrës që nga prilli i vitit 2022 (*pa dashur për asnjë moment të minojmë punën e mirë të bërë nga u.d. Kryeprrokurori i Shtetit*). Si rezultat i numrit të vogël të prokurorëve dhe stafit mbështetës, prokuroria e shtetit gjatë vitit 2023 nuk ka arritur të tregoj efikasitetin e duhur, ka pranuar 52,093 lëndë, gjatë këtij viti ka arritur të kryej 41,973 lëndë, përderisa të trashëguara nga vitet paraprake kanë ngelur edhe 99,257 lëndë, e dhënë kjo që flet përfshirë nevojën e rritjes së numrit të prokurorëve dhe stafit mbështetës.

Pavarësishët të lartcekurave, institucioni i Prokurorit të Shtetit megjithatë ka treguar vullnet dhe ka prirje përfshirë avancimin në trajtimin e të drejtave të njeriut, rasteve të korruptionit, trajtimin e rasteve të dhunës në familje, krimet ekonomike deri te prioritizimi i trajtimit të rasteve të medias duke garantuar kështu edhe lirinë e shprehjes dhe duke forcuar pavarësinë, llogaridhëni, cilësinë dhe efikasitetin në punë. Institucioni i Prokurorit të Shtetit ka treguar sukses dhe progres edhe në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së krijuar me vepër penale, përderisa viteve të kaluara shifrat e konfiskimit me aktgjykim të gjykatës ishin tre shifrore: në vitin 2023 janë sekuestruar 87 milion euro dhe **janë konfiskuar me vendime të gjykatës 23.5 milion euro.**

2. Si e vlerësoni gjendjen aktuale në prokurorinë përfshirë cilën keni aplikuar?

Prokuroria Themelore e Prizrenit, shikuar në retrospektive ka shënuar progres dhe vlerësoj se ka ndryshime tejet pozitive, përderisa ballafaqohet me sfida të shumta përfshirë.

shkak të karakteristikave që ka, kjo edhe për shkak të topografisë nga fakti se kufiri me Shqipërinë nga njëra anë dhe pjesërisht ai me Maqedoninë në anën tjetër, sjellë shumë vepra specifike dhe shton bashkëpunimin e krimit. Prokuroria e Prizrenit, gjatë vitit 2023 nga të gjitha regjistrat, ka pranuar 5,216 lëndë, ndërsa ka kryer 4,549 lëndë, vlen të theksohet se në fund të vitit 2023 në punë kanë mbetur 10,488 lëndë. Edhe përkundër këtij efikasiteti në Prokurorinë Themelore të Prizrenit ka ende shumë për t'u bërë, pa dyshim që objektiva kryesore do të jetë rritja e cilësisë së hetimeve, shkresave të lëndës dhe përfaqësimit në gjykatë, pa përjashtuar avancimin sa i përket transparencës ndaj publikut dhe llogaridhëniec së vazhdueshme të punës së prokurorëve.

### *3. Cilat janë mangësitë dhe sfidat kryesore të kësaj prokurorie?*

Shikuar në vlerësimin tim, vlerësoj se Prokuroria Themelore e Prizrenit, nuk është imune ndaj mangësive dhe sfidave, të cilat i listoj si më poshtë: numri i vogël i prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional; numri i vogël i sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurisë specifike duke përfshirë edhe aplikimin e LKZK-së; numri i madh i lëndëve të pa zgjidhura nga regjistri PPP;<sup>1</sup> profilizimi i prokurorëve dhe ngritja e vazhdueshme profesionale; rritja e aplikimit të procedurave alternative; ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike - përkatësisht ndërtimi i objektit për PTH Prizren;<sup>2</sup> prezantimi i punës së prokurorisë para publikut, mediave dhe shoqërisë civile, mbi të gjitha sfidë kryesore do të jetë rritja e besimit të qytetarëve në institucionin e prokurorit të shtetit.

### *4. A mendoni se strategjitet aktuale të sistemit adresojnë nevojat e prokurorisë për të cilën aplikoni si Kryeprokuror?*

Prokuroria Themelore në Prizren, sikurse edhe prokuroritë tjerë, në vazhdimësi ka zhvilluar politika menaxheriale në fryshtë e politikave të vendosura nga KPK dhe PSH, po ashtu do të vazhdohet bashkëpunimi me Akademinë e Drejtësisë në drejtim të identifikimit të temave specifike dhe nevojave konkrete për trajnime shtesë për prokurorët. Bazuar në strategjitet aktuale, do të hartohen planet e punës në bashkëpunim me kabinetin që do ta formoj në kuadër të prokurorisë dhe ai plan i punës përveç hartimit do të ketë edhe monitorim të vazhdueshëm dhe do të ketë promovim të të njëjtë. Për aq sa më jepen mundësitetë, synoj profilizimin e prokurorëve, do të kërkojë ngritjen e kapaciteteve profesionale, numër të nevojshëm të prokurorëve dhe stafit, e sidomos të bashkëpunëtorëve profesional të cilët pa dyshim që luajnë rol kyç në aspektin e lehtësimit të punës dhe ngritjen profesional të prokurorisë.

## ➤ II. Vizioni juaj për përmirësimin e punës operative në prokurorinë që keni

<sup>1</sup> Aktualisht në Prokurorinë e Prizrenit, gjenden të pakryera 9,259 lëndë nga regjistri PPP, ky regjistër e rrítë numrin e lëndëve të pakryera.

<sup>2</sup> KPK ka ndërmarrë veprime në drejtim të institucioneve përgjegjëse për ndarjen e një parcele afér parcelës së ndarë për Gjykatën e Prizrenit (*kjo e fundit tashmë ka filluar ndërtimin*) por ende nuk ka ndonjë përgjigje pozitive dhe kjo dukshëm do të ndikojë në punën e prokurorisë në përfaqësim të seancave gjyqësore për shkak të largësisë me objektin e gjykatës.

## **aplikuar? 1. Cili është vizioni juaj për të përmirësuar punën operative gjatë mandatit tuaj?**

Në radhë të parë, është ofrimi i trajtimit të barabartë për të gjithë para ligjit, mbi të gjitha trajtimi i punëve në mënyrë efikase, transparente, llogaridhënëse dhe profesionale, e cila synim në qendër ka trajtimin në mënyrë meritore të viktimate të krimit dhe besimin e publikut. Të forcohet bashkëpunimi ndërinstitucional dhe të rritet cilësia e hetimeve me theks të veçantë në veprat penale më të shprehura në regjionin e Prokurorisë së Prizrenit. Ky vizion do të realizohet përmes përfshirjes së akterëve kryesor menaxhues të prokurorisë së Prizrenit përmes planit vjetor të punës, duke mos përjashtuar idetë pozitive të secilit pavarësish pozitës që mbanë. Plani i punës, do të ketë edhe plan të raportimit për secilin departament nga përgjegjësit e tyre, në mënyrë që të mbahet në kontroll dhe të realizohet ajo që paraprakisht është planifikuar me planin e punës. Do të kujdesem që të dalim me statistika të sakta, sidomos në drejtim të mbledhjes së të dhënave statistikore për rastet e sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurisë, gjë e cila deri më tani është e pa rregulluar si duhet dhe shkrimorja e prokurorisë nuk i pranon dhe gjeneron të dhënrat statistikore të sakta nga kjo fushë!

## **2. Cilat janë objektivat tuaja kryesore?**

Koncept dokumenti im për Prokurorinë Themelore të Prizrenit, do të mbështetet në pesë (5) objektiva kryesore, të cilat ngërthejnë në vete nën-objektiva tjera:

- I. rritja e besimit të publikut në institucionin e prokurorit të shtetit, përmes ngritjes së transparencës, llogaridhënieς dhe bashkëpunimit ndërinstitucional;**
- II. ngritja e cilësisë, efikasiteti dhe menaxhimi i mirë;**
- III. trajtimi me prioritet i veprave penale më të shprehura;**
- IV. rritja e numrit të zgjidhjes së rasteve përmes procedurave alternative;**
- V. sekuestrimi dhe konfiskimi.**

**1. Sa i përket objektivit të parë, për të rritur besimin e publikut, transparencën, llogaridhëniën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, do të synojë që këtë objektiv ta arrijë përmes nëntë (9) nën-objektivave të renditura si më poshtë:**

**1.1. Fuqizimi i Zyrës për Informim,-** përvèç komunikatave ditore dhe publikimit të raportit 24h, zyra për informim do të rrisë përfaqësimin në media të shkruara dhe televizive për rastet që përbëjnë interes për publikun, gjithmonë duke pasur në fokus ekilibrin në mes transparencës dhe interesit publik, si dhe interesin e hetimit. Po ashtu, zyra për informim do të angazhohet edhe në drejtim të paraqitjes së ankesave në KMSHK dhe KPM, në rastet kur përmes lajmeve të pavërteta cenohet institucioni i prokurorit të shtetit.

**1.2. Takimet me institacione tjera,-** përgjatë tre mujorit të parë të punës dhe në vazhdimësi, do të aranzhoj takime me akterët kryesor siç janë: gjykata, policia, doganat,

IPK, NJIF, AKK, ATK, AAPSK, QPS, Shërbimi Sprovues etj, me qëllim që të forcojmë bashkëpunimin ndërinstiucional, të ndërtojmë fryshten e punës ekipore dhe të përmirësojmë cilësinë e punës.

**1.3. Takimet me qytetarë,-** një ditë në javë (*të mërkurave nga ora 13:00<sup>min</sup> – 15:00<sup>min</sup>*) do të organizohet takimi i kryeprokurorit me qytetarë.

**1.4. Takimet me gazetarë dhe shoqërinë civile,-** përjashtuar qasjes individuale përgjatë gjithë vitit, të paktën në çdo fund vit, do të organizohet takimi me gazetarë dhe shoqërinë civile, ku do të prezantohen rezultatet e punës së prokurorisë dhe në vazhdimësi do të jepen përgjigje dhe prononcime për media duke përfshirë edhe organizimin e konferencave.

**1.5. Ligjératat me studentë dhe nxënës të shkollave,-** do të mbahen ligjérata për studentë, në mënyrë që të njëjtët të njoftohen më për së afërmë me punën e prokurorit dhe me këtë të rritet edhe aplikimi i praktikantëve në prokurori. Po ashtu, prokuroret e Departamentit për të Mitur, do të zhvillojnë aktivitete me të rinjtë në shkolla të mesme dhe fillore, me qëllim të rritjes së sigurisë dhe vetëdijesimit të të miturve.

**1.6. Shqyrtimi i detyrueshëm i lëndëve,-** çdo tre (3) muaj, do të shqyrtoj lëndët për secilin dhe me secilin prokuror dhe do të konstatohet nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet apo të ngritet aktakuza dhe për këtë do të mbahet shënim zyrtar në secilën lëndë.

**1.7. Mbajtja e kolegjiumeve dhe raportet mujore të punës së prokurorëve,-** çdo muaj me prokurorët do të diskutohen rezultatet dhe ngecjet në punë dhe do të trajtohen zgjidhjet adekuate. Brenda muajit do të organizohen së paku dy (2) kolegjiume me të gjithë prokurorët e të gjitha departamenteve dhe sipas nevojës brenda muajit do të organizohet edhe një kolegjum i ndarë me ndonjërin nga departamentet, varësisht nga temat e nevojshme të paraqitura, ku në çdo kolegjum të mbajtur do të përpilohet procesverbal me konkluzionet e nxjerra dhe pas mbajtjes së kolegjumit do të shpërndahet procesverbali tek të gjithë prokurorët.

**1.8. Llogaridhënia e prokurorëve dhe stafit mbështetës,-** përmes kontrollit dhe mbikëqyrjes do të rritet llogaridhënia. Aty ku do të kemi shkelje të kodit të etikës dhe veprime të pa përmirësueshme do të ketë reagim të menjëhershëm, do të ketë veprime në vlerësim të performancës dhe aty ku është e nevojshme dhe e domosdoshme, do të iniciohet procedurë disiplinore.

**1.9. Raporti me prokurorët dhe stafin mbështetës,-** do të bëjë përpjekje maksimale që t'i trajtoj në mënyrë të barabartë, me objektivizëm, do të vazhdoj të jem parimor dhe do të ndërtoj fryshten ekipore duke garantuar pavarësinë profesionale, do të krijoj ambient pozitiv dhe do t'i inkurajoj dhe vlerësoj për punën e mirë brenda dhe jashtë institucionit.

**2. Për ta ngritur cilësinë, efikasitetin dhe menaxhimin e mirë, do të bëjë përpjekje që këtë objektiv ta arrije përmes bashkëpunimit të brendshëm me stafin e prokurorisë, duke përbushur nëntë (9) nën-objektiva si më poshtë.**

**2.1. Akte cilësore,-** ndër objektivat kryesore do të jetë cilësia dhe efikasiteti i aktakuzave përmes hetimeve cilësore dhe kontrollit menaxhues të vazhdueshëm. Në rastet kur kemi aktakuza të dobëta, pa dyshim që një gjë e tillë do të reflektojë në vlerësimin e performancës së prokurorit.

**2.2. Përfaqësimi në seanca gjyqësore,-** do të kem kontroll në procesverbalet e përfaqësimeve, do të marrë pjesë kohë pas kohe në vëzhgim dhe vlerësim të prokurorëve në seanca gjyqësore, mirëpo në radhë të parë do të bëjë organizimin e duhur dhe të barabartë për të gjithë prokurorët për pjesëmarrje në seanca gjyqësore.

**2.3. Shfrytëzimi i kapaciteteve të brendshme profesionale,-** përveç kryeprokurorit, do të angazhohen edhe udhëheqësit e departamenteve dhe koordinatorët e fushave specifikeve, të cilët do të mblidhen sa herë që është e nevojshme në lëndë të caktuara komplekse ku do të shfrytëzohen njohuritë e gjithsecilit për të arritur rezultate pozitive. Kjo trupë vlerësoj që do të sigurojë ngritje të cilësisë në punë dhe do të instalohet bashkëpunimi dhe fryma ekipore në prokurori.

**2.4. Përdorimi i sistemit SMIL,-** edhe pse përdorimi i sistemit SMIL në Prokurorinë e Prizrenit duket të jetë bukur i avancuar dhe në përdorim stabil, vlerësoj që aty ku evidentohen ngecje do të bëhet kombinimi i stafit administrativ të përgatitur - zyrtarëve ligjor me prokurorët që kanë ngecje në përdorim të SMIL-it.

**2.5. Mbështetje e forcuar për prokurorët në krimet e rënda,-** nga prokurorët e DKR do të kërkohet më shumë angazhim, andaj do t'u afrohet nga një bashkëpunëtor profesional për të lehtësuar punën e tyre, sidomos nisur nga fakti që pothuajse të gjithë prokurorët e DKR-së, janë afér moshës së pensionimit. Angazhimi i një bashkëpunëtori në zyre do ta mban nën kontroll të plotë zyrën dhe do ta ngritë cilësinë në punë.

**2.6. Angazhimi i ekspertëve,-** caktimi i ekspertëve të fushave të ndryshme do të bëhet sipas respektimit të një liste të vetme ngase ka vërejtje nga ekspertët për mos respektim të listës, si dhe do të bëhet aplikim i standardit të njëjtë për pagesa të ekspertëve ngase për punën e njëjtë shpesh paraqiten situata kur pagesat janë të ndryshme.

**2.7. Takime të rregullta me stafin mbështetës,-** do të mbahen takime të rregullta tre mujore, (në prezencë të administratorit) me bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjor dhe zyrtarët e shkrimores.

**2.8. Vlerësim profesional i Bashkëpunëtorëve Profesional,-** do të bëhet nga administratori në konsultim të ngushtë me prokurorin e zyrës dhe kryeprokurorin, ashtu siç përcakton neni 31 i Rregullores nr.05/23 për Organizimin e Brendshëm dhe Funksionimin e Prokurorit të Shtetit. Bashkëpunëtorët profesional do të angazhohen edhe në zvogëlimin e numrit të lëndëve nga regjistri PPP dhe po ashtu të njëjtit do të

paraqesin raporte mujor për punët e kryera, në mënyrë që të kemi kontroll dhe shpërndarje të barabartë të punëve.

**3. Sa i përket priorititetit në hetimet e veprave penale dhe ndjekjes së kryesve, fokusin e veçantë do ta koncentroj në veprat penale të korruptionit, fajdesë, narkotikëve, krimeve kundër mjedisit dhe dhunës në familje.**

**3.1. Korrupsioni**,- lufta e prokurorisë për ndjekjen dhe zbulimin e kryesve të veprave të tillë do të vazhdojë të jetë prioritet kryesor derisa puna jonë do të tregoj rritje të besimit të qytetarëve në institucionin e prokurorit të shtetit. Beteja kundër korruptionit mbetet e vazhdueshme për sundimin e ligjit, do të kem angazhim më të shtuar edhe nga pozita e kryeprokurorit, si dhe do të thellohet bashkëpunimi me institucionet relevante duke përfshirë Drejtoren e Krimeve Ekonomike, Doganat, ATK-në dhe bashkëpunimin me qytetarët për zbulimin dhe ndjekjen e zyrtarëve të tillë, në mënyrë që kjo prokurori të vazhdojë të tregojë suksese nga kjo fushë siç ka bërë në vazhdimësi në ndjekjen, hetimin dhe ngritjen e dhjetëra aktakuzave ndaj zyrtarëve të lartë komunal.

**3.2. Fajdea**,- duke e parë si dukuri shqetësuese dhe në rritje në regionin e Prokurorisë Themelore të Prizrenit, nga pozita e kryeprokurorit do të inkurajoj të gjithë kolegët prokurorë për angazhim dhe do të bëjë përpjekje maksimale që ta çrrënjosë nga regjioni i Prizrenit këtë veprimtari të kundërligjshme e cila pothuajse ka kaluar në dukuri! Si vepër penale e përbërë, përveç dëmeve pasurore jemi dëshmitarë që rastet e tillë përfundojnë edhe me detyrime dhe me vepra penale kundër jetës dhe trupit, andaj viktimate të fajdesë do t'u ofrohet mbrojtje dhe do të trajtohen me prioritet. Përveç arrestimeve dhe dënimive, kryerësit e këtyre veprave penale do të ballafaqohen edhe me sekuestrime dhe konfiskime të pasurive specifike, duke përfshirë dobinë pasurore të përsituar me vepër penale, mjetet e kryerjes, dhuratat e njolllosura, do t'u konfiskohet pasuria zëvendësuese dhe do të aplikohet aty ku mund të gjejmë bazë edhe LKZK, në mënyrë që të përçojmë mesazh për preventivë gjenerale. Rastet e tillë pa dyshim që do të bëjmë përpjekje t'i bëjmë edhe publike përmes zyrës për informim dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në media dhe konferanca për shtyp.

**3.3. Narkotikët**,- shpesh kufiri me shtetin fqinj Shqipërinë na sjell edhe vepra penale të ndryshme, ndër më të theksuarat narkotikët, andaj në këtë drejtim do të fuqizoj bashkëpunimin me DHTN – Njësia në Prizren, doganat dhe zyrtarët e vijës kufitar, me qëllim të fuqizimit të kontrollit kufitar dhe parandalimit të transportit të narkotikëve, do të shpeshtohet aplikimi i masave të veçanta hetimore ngase numri i përdoruesve të drogave në Kosovë është në trend të rritjes, ndërsa konsumues gjithnjë e më të shpeshtë na paraqiten moshat e reja.

**3.4. Krimeve kundër mjedisit**,- tashmë janë një nga veprimtaritë më të rrezikshme globale, komuniteti ndërkombëtar ka zhvilluar një gamë rregullash, direktiva e konventa për ta mbrojtur mjedisin. Në regionin e Prizrenit, degradimi më i madh shkaktohet nga vjedhjet e pyllit, e në veçanti nga eksplloatuesit e rërës dhe të zhavorrit

në lumin "Drini i Bardhë", të cilët përmes veprimtarisë së kundërligjshme janë duke i ndërruar edhe rrjedhën natyrore të lumiit, gjë që paraqet rrezik permanent për përbimitje. Ekspluatuesit e tillë operojnë për kohë të gjatë pa licenca dhe në këtë drejtim për të pasur sukses në hetim dhe luftim, përveç me policinë do të rritet bashkëpunimi dhe do të angazhohen inspektorët e KPMM-së dhe të ambientit dhe do të bëhet inkurajimi dhe angazhimi më i madh i koordinatorit nga kjo fushë, duke vlerësuar se mënyra më e mirë për të ndaluar këtë veprimtari të kundërligjshme do të jetë sekuestrimi i mjeteve dhe të dobisë pasurore, duke përfshirë *kamionët, eskavatorët dhe seperacionet*, si dhe shitjen e mjeteve në fazë të hershme për çmimin e tregut.

**3.5. Dhuna në familje,-** duket qartë se është fenomen global në rritje, një gjë e tillë po ndodhë viteve të fundit edhe në regionin e Prizrenit, andaj në këtë drejtim do të angazhoj dy prokuore koordinatore nga DP dhe një prokuore koordinatore nga DKR, të cilat do të merren ekskluzivisht vetëm me trajtimin e rasteve të dhunës në familje duke përcjellë rastet nga fillimi i hetimit, përfaqësimi në seanca gjyqësore dhe deri të parashtrimi i mjeteve juridike për rastet e tillë. Do të thellohet bashkëpunimi me mekanizmin për parandalimin e rasteve të dhunës në familje duke përfshirë policinë, mbrojtësit e viktimate, QPS-në, si dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare.

#### **4. Rritja e numrit të zgjidhjes së rasteve përmes procedurave alternative**

Gjatë mandatit katër vjeçar synoj të arrijë rezultate pozitive dhe të rris numrin e rasteve të zgjidhura përmes procedurave alternative nga **15 - 20% të lëndëve**. Përveç procedurës së ndërmjetësimit e cila tashmë duket se ka gjetur aplikimin e duhur nga prokurorët, do të insistohet tek prokurorët që të rrisin numrin e rasteve të zgjidhura me arritjen e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë, do të aplikohen dispozitat që kanë të bëjnë me kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme, e po ashtu do të rriten rastet e pezullimit të përkohshëm të procedurës penale, si mundësi tejet të mira për trajtimin e lëndëve. Çështja e kompensimit të viktimate të krimtit duhet të jetë prioritet dhe përkushtim i prokurorëve me rastin e zgjidhjes së rasteve me procedurë alternative.

#### **5. Rritja e numrit të procedurave të sekuestrimit dhe konfiskimit.**

Rastet penale që kanë të bëjnë me përfitim pasuror, gjatë mandatit tim *asnje i tillë* nuk do të kalojë pa ndërmarrje të **hetimeve financiare** në drejtim të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të specifikuara, në të kundërtën prokurorët që nuk do t'i ndërmarrin veprimet e tillë do të ballafaqohen me vlerësimë të ulëta të performancës. Do të inkurajohen prokurorët që në rastet ku plotësohen kushtet të bëhet **shitja e aseteve në fazë të hershme** në mënyrë që të ruhet vlera e sendit dhe të mos ngarkohet AAPSK dhe stacionet policore me mjete të cilave u humbet shpejt vlera. Fokus tejet i veçantë do t'i jepet identifikimit të rasteve për aplikim të **Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit të Pasurisë** dhe një gjë e tillë vlerësoj se nuk do të jetë vështirë e realizueshme ngase të gjitha aktgjykimet fillimisht kalojnë në duar të kryeprokurorit dhe aty do të jetë mundësia e lehtë për t'u njojur me natyrën dhe identifikimin e rasteve, shto këtu faktin se kryeprokurori do të jetë në dijeni për secilin rast, sidomos

të atyre me peshë më të madhe qysh në fazën e hershme të hetimit. Kontrolli dhe motivimi i kolegëve do të bëhet përmes kolegjumeve të rregullta dhe takimeve individuale.

### *3. Cilat janë sfidat që prisni gjatë përbushjes së këtyre objektivave?*

Sfidat të cilat mund të paraqiten gjatë përbushjes së objektivave të lartpërmendura janë vlerësuar të jenë: plotësimi i pozitave të nevojshme për prokurorë dhe stafin mbështetës profesional; lëndët e vjetra të grumbulluara në regjistrin PPP; rritja e cilësisë së hetimit dhe përpilimit të aktakuzave në drejtim të zvogëlimit të numrit të aktgjykimeve refuzuese dhe ngritja e besimit të qytetarëve në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

### *4. Si do t'i tejkalonit ato?*

Sfidat e listuara më lartë, do të tejkalojen duke u mbështetur fillimisht në vullnet personal, pastaj në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Këshillin Prokurorial duke përfshirë edhe sekretariatin e këshillit dhe pa dyshim me Kryeprokurorin e Shtetit. Gjithashtu, këto sfida do të arrijë t'i tejkaloj në bashkëpunim edhe me institucionet tjera ligjzbatuese, varësisht nga nevoja dhe fusha sfiduese, mbi të gjitha do të ekzistojë bashkëpunimi i ngushtë i brendshëm me prokurorët dhe stafin administrativ pa të cilët nuk mund të tejkalohet asnjë sfidë e vetme. Do të realizohen takime të rregullta dhe në vazhdimësi do të nxjerrim analiza për çështje konkrete dhe me padyshim që do të arrijmë te rezultatet pozitive. Mbi të gjitha tejkalimi i këtyre sfidave kërkon përkushtim, përvojë dhe punë ekipore, të cilat pa dyshim që nuk i mungojnë personalitetit tim.

## ➤ III. Vizioni për të menaxhuar personelin në sistemin prokurorial

### *1. Cili është modeli juaj në menaxhimin e stafit?*

Stafi administrativ është garantues për suksesin e prokurorisë në përgjithësi, në këtë drejtim kujdes i veçantë do t'i kushtohet forcimit të menaxhimit në drejtim të rritjes së efektivitetit në punë përmes llogaridhënieve dhe mbikëqyrjeve së shtuar. Ndër hapat e parë që do të ndërmerren, do të jetë respektimi i mirëfilltë dhe korrekt i orarit të punës, etika në punë, mirësjellja ndërkolegiale dhe me palët, si dhe respektimi i konfidencialitetit në punë. Në bashkëpunim të ngushtë me administratorin e prokurorisë dhe udhëheqësit tjérë administrativ, gjithmonë duke shpërfaqë punë ekipore do të bëhet rishikimi i strukturës organizative të administratës, do të ngritën kapacitetet njerëzore dhe profesionale, do të digitalizohen shumë nga proceset e punës duke përfshirë edhe fuqizimin e llogaridhënieve dhe do të bëhet vlerësimi i performances në bazë të parimit të meritës. Do të investohet në proaktivitet dhe do të instalohet frymë ekipore ku për çdo ngecje të vërejtur do të mbahen takime të brendshme dhe gjithashtu përvèç identifikimit dhe mbajtjes së trajnimeve qendrore, do të mbahen trajnime të administratës nga kolegët më me përvojë brenda prokurorisë në Prizren, gjë e cila do të shërbejë për të kryer shërbimet teknike-administrative në mënyrë sa më profesionale. Do të shtohet vigjilanca e parashtrimit me kohë të

kërkjesave për zëvendësimin e stafit që avancohet apo shkojnë në pension, do të kërkohet rritja e numrit të zyrtarëve ligjor dhe referentëve si dhe rritja e numrit të bashkëpunëtorëve profesional derisa të arrihet numri një bashkëpunëtor një prokuror. Stafi administrativ do të ketë një mjedis të punës të motivueshëm, ku secili do të vlerësohet për kontributin që jep dhe do të krijohen hapësira dhe mundësi për avancimin e të njëjtëve.

### *2. Si planifikoni ndarjen e barabartë të punës për stafin?*

Në bashkëpunim me Administratorin e Prokurorisë dhe udhëheqësit e departamenteve do të bëjmë ndarjen e punëve duke u mbështetur në parimin e transperencës dhe të barazisë duke marrë për bazë rëndësinë e secilit sektor, ndarja e detyrave për secilin do të bëhet në mënyrë të barabartë duke siguruar veprim efektiv dhe efikas të prokurorisë. Shkrimorja e prokurorisë është zyra kryesore e mbajtjes së evidencave për të gjithë punën e prokurorisë, për këtë arsyе ka rëndësi të veçantë, andaj në bashkëpunim me administratorin do të kërkohet raportim në baza javore dhe mujore, madje me raste edhe në baza ditore nga përgjegjësi i shkrimores lidhur me punën e shkrimores.

### *3. Si planifikoni të përmirësoni llogaridhëni dhe profesionalizmin e stafit?*

Në fryshtës së legjislacionit primar dhe sekondar, do të kërkohet që stafi të ushtrojë detyrën me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. Stafi ka për obligim të veproj në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësi i tij (*administratori dhe prokurori i zyrës*) sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të Prokurorisë. Do të kërkoj një sistem të vlerësimit të punës së stafit, duke u dhënë mundësi që të përmirësojnë aftësitë profesionale përvendin e punës nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme, po ashtu në bashkëpunim me administratorin do të bëhet raportim favor përmes një sistemi elektronik dhe do të mbahen takime të rregullta përsfidat dhe propozimet pozitive në punë.

## **IV. Hapat që do të ndërmerrni për përmirësimin e integritetit dhe llogaridhënisë së sistemit, prokurorisë dhe besimit të publikut?**

### **1. Çfarë hapash do të ndërmerrni për të ngritur nivelin e besueshmërisë në Prokurorinë tuaj, duke vënë baraspeshë mes transparencës dhe konfidencialitetit të procedurës?**

Fillimi i vlerësimit që për të ngritur nivelin e besueshmërisë së institucionit në drejtim të transparencës duhet të kemi njohuri më të thella në fushën e komunikimit me publikun, aftësi të cilën besoj që e posedoj ngase përtetë vite e gjysmë kam punuar në shoqëri civile dhe media, madje kam qenë edhe fitues i çmimeve vjetore në gazetari dhe kam mbajtur gjithashtu pozita të rëndësishme menaxhuese nga fusha e mediave. Në radhë të parë do të qëndrojë i informuar koherent për zhvillimet e fundit, do të jem transparent fillimi i më kolegët ku punoj, e pastaj do të shtrijë këtë transparencë edhe me publikun, gjithmonë duke ruajtur konfidencialitetin në fryshtës së strategjisë institucionale për komunikim me publikun dhe rregulloret në fuqi. Në asnjë rast nuk

do të plasohet në publik ndonjë informacion i cili do të ndikoj në dëmtimin e hetimeve. Do të organizojmë takime të rregullta me publikun për t'i informuar rrith punës së prokurorisë, do të aplikohen mediat sociale përmes faqes së prokurorisë për të ndarë lajme dhe informacione me publikun, sa herë që është e nevojshme do të organizojmë konferenca për media dhe gjithashtu në interes të institucionit prokurorial do të marrim pjesë edhe në debate televizive dhe do të marrim pjesë në fusha të ndërgjegjësimit me qëllim parandalimin e veprave penale.

Qytetari ka nevojë për prezantim të punës së prokurorisë, ka nevojë të shohë lajme pozitive nga sistemi i drejtësisë, gjë të cilën jam i bindur që do të arrijë me sukses ta realizoj duke rritë përmirësimin e transparencës dhe integritetin prokurorial, me këtë besoj fuqishëm se do të ngritet edhe niveli i besueshmërisë së publikut.

### ***2. Cilat janë planet tuaja për të sigruuar punë cilësore në Prokurorinë tuaj?***

Kapacitetet menaxhue se do t'i forcoj nëpërmes ndarjes së përgjegjësive, të cilën do ta bëjë duke caktuar prokurorë me integritet të lartë si përgjegjës të departamenteve, koordinatorë të fushave përkatëse dhe do të formoj kabinetin, me qëllim të sigurimit të punës cilësore. Pjesë e kabinetit do të jenë: kryeprokurori, zv. kryeprokurori, udhëheqësit e departamenteve dhe koordinatorët e prokurorisë, me të cilët do të mbajmë takime të rregullta mujore. Ndarja e disa përgjegjësive menaxheriale te pjesëtarët e kabinetit, do ta lehtësojnë menaxhimin dhe njëkohësisht do të arrijmë të kontrollojmë edhe kualitetin e punës. Do të forcohet koncepti i punës ekipore, në raste specifike do të angazhohet në të njëjtën lëndë edhe prokurori koordinator i fushës përkatëse.

Do të thellohet edhe më tutje bashkëpunimi me gjykatën dhe në koordinim do të caktojmë *një ditë të javës* në të cilën gjykatësit nuk do të caktojnë seanca gjyqësore dhe me këtë do t'u mundësohet koordinim më i lehtë i prokurorëve që të planifikojnë marrjet në pyetje dhe ndërmarrjen e veprimeve hetimore, me këtë edhe ngritjen e cilësisë në punë.

### ***3. Cilat janë planet tuaja për përmirësimin e llogaridhënieve së përgjithshme në Prokurorinë tuaj?***

Shumë nga objektivat tashmë janë dhënë edhe më lartë, përveç mekanizmave të krijuara nga KPK dhe PSH, në bashkëpunim me prokurorët do të kujdesem të rrisim cilësinë e hetimit dhe përpilimit të akteve procedurale, do të ketë pjesëmarrje me kohë në seanca gjyqësore dhe do të forcohet gatishmëria për zëvendësimin e kolegëve që kanë arsyë për mungesën e tyre, të jenë vigjilent gjatë kujdestarisë dhe të konsultohen me kryeprokurorin dhe udhëheqësit e departamenteve si dhe me koordinatorët para se të lëshohet ndonjë gabim që cenon integritetin dhe imazhin e prokurorisë. Të jenë efikas e efektiv dhe mbi të gjitha të jenë të përgjegjshëm në punë duke ndjekur praktikat më të mira vendore e ndërkombëtare. Si vendimmarrës, në misionin tim për sundimin e ligjit e konsideroj çështje rrënjosore sigurimin e llogaridhënieve, e cila garanton ngritjen e cilësisë dhe rritë besimin qytetarë në sistemin prokurorial të Kosovës.

Konceptdokumenti nuk duhet të përbajë më shumë se 10 faqe me shkrimin e llojit  
Book Antiqua, madhiësia 12, hapësira njëshe.

Deklaroj se përbajtjen e këtij konceptdokumenti e kam përgatitur vetë dhe jam  
në dijeni se pas emëritit, i njëjti do të publikohet në uebportali.

Nënshkrimi: Zefir

Datë: 06.11.2024